



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.995/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Kymete Kicaj dhe Adnan Konoshevcu anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e Kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, Alban Bajrami ,nga Subjekti Politik,Partia Demokratike e Kosoves( PDK) dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numer 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021 mori kete ;

## V E N D I M

**Hudhet i parregullt apeli** Anr.995/2021, i datës 04.11.2021, i parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Alban Bajrami nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves( PDK), dega në Lipjan, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

## A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i, ka pranuar një apel të parashtruar nga Kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, Alban Bajrami nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK) dega në Lipjan. Në apelin e tij parashtruesi ka theksuar se ju kanë keqpërdorur,manipuluar Votat. dhe kërkon nga PZAP qe ta shqyrtoj Apelin dhe te marre vendim per rinumrimim të votave .Parashtruesi i apelit si dëshmi ia ka bashkangjitur emrat e dëshmitarve që e kanë votuar dhe numrat personal te tyre.Por nuk e ka nënshkruar formularin e apelit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

### **Apeli është i parregullt**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoi se apeli i paraqitur nga Alban Bajrami, është i parregullt, sepse apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”*. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet per kontaktim të personit që e dorëzon apelimin

- b) arsyen për dorëzimin e apelimit.
- c) hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimit.
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur sepse e njëjta ankese fare nuk është nënshkruar nga ankuesi.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.995/2021 më datën 07.11.2021.**



**Kryesuesja e Panelit**  
**Zyhdë Haziri**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.